

Emri i Lëndës : Konceptim dhe Menaxhim Fushatash							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 523	C	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Edlira Mali, MSc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Lënda synon të jap njohuri të detajuara mbi organizimin dhe menazhimin e fushatave zgjedhore. Puna dhe procesi mësimor në këtë lëndë do të zhvillohet në shkëmbim eksperiencash midis lektorit dhe studentëve. Një rëndësi e veçantë do t'u kushtohet projekteve që studentët do të punojnë në mënyrë individuale apo në grup. Pjesëmarrësit e kursit do të ndërtojnë portfolet individuale të komponentëve të fushatës zgjedhore, të tilla si deklaratat e kandidatit, si dhe të kontribuojnë në dallimet ndër-juridiksionale në mënyrë krahasuese të projektit të menaxhimit të fushatës zgjedhore.					
Objektivat		- Zhvillimi dhe kuptimi i një ndarjeje të duhur të punës në mes kandidatit dhe menaxherit - Duke pasur parasysh të dhënat e votuesve, të zhvillojë një angazhim të medias për të mbështetur fushatën. - Përdorimi i të dhënave të zgjedhësit për të zhvilluar një buxhet të përshtatshëm (dhe me kosto të ulët) fushate, duke përfshirë edhe planet realiste për ngritjen e fondeve. - Hartimi i një plani për shfrytëzimin maksimal të vullnetarëve. - Krijimi i një analize krahasuese për drejtimin e fushatave zgjedhore në juridiksione të ndryshme lokale (në një sërë vendesh në varësi të pjesëmarrësve)					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Kuptimi i problematikës. Bazat dhe elementët kryesorë të një fushate. Llojet e ndryshme të fushatave.						
2	Brainstorming, diskutime, debitime për konceptimin e fushatës – projekt semestral. Planifikimi i elementeve të ndryshme të fushatës. Elementët e ndryshëm të fushatës, grupi i punës ndarja e detyrave.						
3	Kandidati dhe vlerësimi i oponencës						
4	Hapja zyrtare e fushatës projekt semestral – përzgjedhja dhe instruktimi i ambasadorëve.						
5	Plani i Fushatës. Rregullat kyçe të Fushatës Elementët e një plani efektiv						
6	Targetimi i audiencës / votuesve						
7	Zhvillimi i Mesazhit të Fushatës						
8	Provim Gjysmëfinal						
9	Sondazhet Politike dhe Raportet Strategjike.						
10	Planifikim i avancuar: Përgatitja e buxhetit dhe mënyrat e mbledhjes së fondeve						
11	Planifikim i avancuar: Kontakti me audiencën dhe ndikimi mediatic. Propagandimi dhe bindja e audiencës.						
12	Fushata online – Roli dhe mënyrat e përdorimit të internetit gjatë fushatës. Deklaratat e kandidatit, e-maillet e drejtpërdrejta dhe telefoni						

13	Menaxhimi i fushatës; Kandidati, menaxheri, stafi dhe vullnetarët.
14	Menaxhimi i fushatave sipas juridiksioneve të ndryshme. Analiza e fushatës - projekt semestral.
15	Prezantim i projekteve të studentëve
16	Provim Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Dennis W. Johnson, No Place for Amateurs; • Political Campaign Planning Manual. A step by step guide to winning elections, National Democratic Institute for International Affairs
Referenca të tjera	• Richard Semiatin, Campaigns on the Cutting Edge • Robert Greene, 33 Stratagems of War
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të kuptojnë elementët e konceptimit të një fushate, duke përfshirë edhe fushatën zgjedhore.
2	Studentët krijojnë një ide më të qartë rreth përdorimi të mjeteve të ndryshme demokratike për menaxhimin e një fushate.
3	Studentët do të jenë në gjendje të hartojnë një buxhet për fushatën dhe të realizojnë ngritjen e fondeve të nevojshme për realizimin e fushatës.
4	Studentët do të jenë të aftë të konceptojnë dhe menazhojnë një fushatë të mirëfilltë.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	1	10	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	20	20
Provimi final	1	40	40
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00